

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpikat 1 dhe 3 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.58/06...198/18 dhe Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 27.03.2023, miratoi këtë:

Q Ë N D R I M P A R I M O R

I

Pjesëmarrja e gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vendimmarrjen e një lënde konkrete nga sfera penale apo civile me rastin e një mjeti juridik të jashtëzakonshëm, nëse me kërkesën për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm nuk është përfshirë periudha e kohëzgjatjes së procedurës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk paraqet arsye për përjashtimin sipas nenit 64 paragrafi (1) pika 6 të Ligjit për procedurë kontestimore, përkatësisht neni 33 paragrafi (2) të Ligjit për procedurë penale në veprimin e lëndëve për shkeljen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

II

Gjyqtari që ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në shkallën më të ulët për lëndët civile apo penale me rastin e të cilës lëndë është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, mund të kërkojë përjashtim në procedurën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në shkallën e parë përkatësisht në shkallën e dytë sipas nenit 33 paragrafi (2) të Ligjit për procedurë penale, përkatësisht neni 64 paragrafi (1) pika 6 të Ligjit për procedurë kontestimore.

A r s y e t i m

Sipas nenit 33 të Ligjit për procedurë penale,

(1) Gjyqtari ose gjyqtari – porotë nuk guxon të ushtrojë veprimtari të gjyqtarit, nëse:

- 1) është i dëmtuar me veprën penale;
- 2) i akuzuari, mbrojtësi i tij, paditësi, i dëmtuari, përfaqësuesi i tij ligjor ose i autorizuari, është shoku i tij martesor, përkatësisht jashtëmartesor ose farefis nga

gjaku në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, në vijën anësore deri në shkallën e katërt, ndërsa sipas krushqisë deri në shkallën e dytë;

3) me të akuzuarin, mbrojtësin e tij, paditësin ose me të dëmtuarin është në lidhje tutorie, person nën kujdestari, adoptues ose i adoptuar, mbajtës ose i mbajtur;

4) nëse në të njëjtën lëndë penale ka marrë pjesë si gjykatës i procedurës paraprake, ka marrë pjesë në hetimin e akuzës para seancës kryesore, ose ka marrë pjesë në procedurë si paditës, mbrojtës, përfaqësues ligjor ose i autorizuar i të dëmtuarit, përkatësisht paditësit, ose është marrë në pyetje si dëshmitar ose si ekspert dhe

5) në të njëjtën lëndë ka marrë pjesë në miratimin e vendimit të gjykatës më të ulët, ose nëse në të njëjtën gjykatë ka marrë pjesë në miratimin e vendimit që refuzohet me ankesë.

(2) Gjykatësi ose gjykatësi – porotë mund të përjashtohet nga ushtrimi i veprimtarisë së gjykatësit krahas rasteve të theksuara në paragrafin (1) të këtij neni, nëse ekzistojnë rrethana të cilat shkaktojnë dyshime në paanshmërinë e tij.

Sipas nenit 64 të Ligjit për procedurë kontestimore, gjykatësi ose gjykatësi – porotë nuk mund të ushtrojë detyrën e gjykatësit:

1) nëse vet është palë, përfaqësues ligjor ose prokurues i palës, nëse me palën është në marrëdhënie si i autorizuar bashkërisht, bashkë obligues ose obligues regresiv, ose nëse për lëndën e njëjtë është dëgjuar si dëshmitar ose ekspert;

2) nëse përkohësisht ose në mënyrë të përhershme punon te punëdhënësi i cili është palë në procedurë;

3) nëse pala ose përfaqësuesi ligjor ose prokuruesi i palës është familjar i palës sipas gjakut në vijë të drejtë deri në çfarëdo shkalle, e në vijë anësore deri në shkallën e katërt, ose është bashkëshort/e, bashkëshort/e ilegjitim/e ose familjar sipas krushqisë deri në shkallën e dytë, pa dallim nëse martesë është ndërprerë ose jo;

4) nëse është tutor, adoptues, mbajtës i familjes ose i mbajtur i palës, i përfaqësuesit të tij ligjor ose i prokuruesi;

5) nëse në lëndën e njëjtë ka marrë pjesë në miratimin e vendimit të gjyqit më të ulët ose të një organi tjetër dhe

6) nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e bien në dyshim paanshmërinë e tij.

Sipas nenit 6 paragrafi (1) të Ligjit për gjykatat, secili ka të drejtë në qasje të barabartë para gjykatës në mbrojtjen e të drejtave të tij dhe interesave të mbështetura juridikisht.

Në nenin 10 paragrafi (1) të Ligjit për gjykatat, përcaktohen parimet themelore të procedurës para gjykatës edhe atë:

1. Parimi i ligjshmërisë
2. Barazinë e palëve
3. Gjykimi në afatin e arsyeshëm.

Sipas nenit 11 paragrafi (1) të ligjit të theksuar, gjyqtari vendos në mënyrë të paanshme me zbatimin e ligjit në bazë të vlerësimit të lirë të dëshmimeve.

Sipas nenit 36 paragrafi (1) nga i njëjti ligj, pala që konsideron se gjykata kompetente e ka cenuar të drejtën e gjykimit në afatin e arsyeshëm, ka të drejtë të

paraqesë kërkesë për mbrojtjen e gjykimit në afatin e arsyeshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërsa sipas paragrafit (4), Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut vepron ndaj kërkesës e cila i plotëson kriteret e përcaktuara në paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni në afat prej 6 muajsh nga parashtrimi i saj dhe vendos nëse gjykata më e ulët e ka cenuar të drejtën për gjykim në afatin e arsyeshëm, duke pasur parasysh me këtë rast rregullat dhe principet e përcaktuara me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, e veçanërisht ndërlikimin e lëndës, sjelljen e palëve në procedurë dhe sjelljen e gjykatës e cila ka vepruar.

Sipas nenit 6 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

1. Secili ka të drejtë që t'i shqyrtohen dhe përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tij civile ose themelimin e çdo kallëzimi penal kundër tij, në mënyrë të drejtë dhe publike, në afat të arsyeshëm, përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme të përcaktuar me ligj. Vendimi shqiptohet publikisht, por gazetarët dhe publiku mund të përjashtohen gjatë tërë procedurës ose një pjesë nga procedura në interes të moralit, rendit publik apo sigurisë nacionale në një shoqëri demokratike, kur kjo i nënshtrohet interesit të të miturit ose mbrojtja e jetës private të palëve në kontest, ose kur gjykata e konsideron të domosdoshme sepse në rrethana të veçanta publiciteti mund të dëmtojte interesat e drejtësisë.

Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të theksuara ligjore si dhe nga përmbajtja e nenit 6 nga Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe praktika e gjykatës në Strasburg, pavarësisht nga fakti që në procedurën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për cenimin e të drejtës për gjykim në afatin e arsyeshëm nuk vendoset për çështjen kryesore, përkatësisht veprën e kryer penale dhe përgjegjësinë penale, as për zgjidhjen e një marrëdhënieje konkrete juridike kontestuese civile, ndërsa në nenin 33 paragrafi (1) – (5) të Ligjit për procedurë penale, si dhe neni 64 paragrafi (1) nga pika 1 – 5 të Ligjit për procedurë kontestimore, në mënyrë gjithëpërfshirëse janë numëruar shkaqet objektive të karakterit absolut për shkak të së cilave gjyqtari patjetër të jetë i përjashtuar, përkatësisht është i përjashtuar nga gjykimi, nuk do të thotë që gjyqtari nuk mund të përjashtohet sipas nenit 33 paragrafi (2) të Ligjit për procedurë penale dhe nenit 64 paragrafi (1) pika 6 të Ligjit për procedurë kontestimore. Kjo për shkak që në nenin 33 paragrafi (2) të Ligjit për procedurë penale, përkatësisht neni 64 paragrafi (1) pika 6 të Ligjit për procedurë kontestimore, janë theksuar shkaqet për përjashtimin e gjyqtarit në procedurën e një lënde konkrete që nuk janë numëruar në mënyrë gjithëpërfshirëse por i janë lënë praktikës gjyqësore që të përcaktojë kriteret standarde.

Duke marrë parasysh atë që, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas nenit 36 paragrafi (1) të Ligjit për gjykatat, duke vepruar mbi kërkesën e një pale për cenimin e të drejtës për gjykim në afatin e arsyeshëm për rregullat dhe principet e përfshira në këtë paragraf, duke u udhëhequr nga neni 10 paragrafi (1) pika 3 nga i njëjti ligj, neni 6 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe principet dhe standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në procedurën për gjykim në afatin e arsyeshëm, dhe për sigurimin e veprimit të paanshëm dhe objektiv të një lënde konkrete në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga ana e një gjyqtari të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund të parashtrahet kërkesë për përjashtim sipas nenit 33 paragrafi (2) të Ligjit për procedurë penale, përkatësisht nenit 64 paragrafi (1) pika 6

të Ligjit për procedurë kontestimore, në qoftë se për të njëjtën lëndë për të cilën është parashtruar kërkesë për cenimin e të drejtës për gjykim në afatin e arsyeshëm, ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët, si dhe vendimin me rastin e një mjeti të jashtëzakonshëm juridik në procedurë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në qoftë se me kërkesën është përfshirë edhe periudha e kohëzgjatjes së procedurës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEANCA E PËRGJITHSHME**